



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:267087
Datë: 23.07.2024
Numri i dokumentit: 05968424

C-IV.-13-1318

Ankuesi

H M nga f.sh L i E K.Podujevë.
Përfaqësuar nga Av.M G, Prishtinë.

Kundër

E paditura

N.SH “Kosova Ndërtimore”, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga “Driton Hoxha”, nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Dr.sc.Murat Hulaj, me dt.19 korrik 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e ankuesit, dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit nr.MIT019-0105 i dt.26 qershor 2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- 2. Secila palë i bartë shpenzimet e veta gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.18 korrik 2013, ankuesi parashtror ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit MIT019-0105 i dt.26 qershor 2013, me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për paga të pa paguara për periudhën Gusht 2001 deri në përmbushje të obligimit ndaj parashtruesit në shumë prej 2,500.00€, për periudhë të pa specifikuar nga NSH “Kosova Ndërtimore” (në likuidim). Ankuesi në ankesë ka pohuar se ankesën e paraqet për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ka shtuar se lidhur me të drejtën e tij i posedon dokumentet e nevojshme të cilat tregojnë te drejtën time, ndaj kësaj ndërmarrje e cila me ka mbetur borgjë për shumën prej 2,500.00 euro. Të njëjtës i ka bashkangjitur Kopjen e vendimit të kundërshtuar, Kopjen e njoftimit për

ndërprerje të marrëdhënies së punës, Kopjen e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Kopjen e aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Vushtri C.nr.1074/05 dt.19.12.2005, Kopjen e aktvendimit të Gjykatës Komunale në Vushtri E.nr.120/06 dt.27.03.2006, Kontrata e punës e lidhur në mes të NSH-së dhe ankuesit nr.8190 dt.01.03.2002.

Me dt.28 prill 2014, e paditura AKP ka parashtruar mbrojtje ndaj ankesës se paraqitur nga ana e Paditësi në DHPGJS ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit (me teje AL), ku e paditura AKP në përgjigje –mbrojte ka pohuar se vendimi i AL nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe dispozitat ligjore në fuqi janë zbatuar drejtë. Konsideron se objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit të kundërshtuar. Parashtruesi nuk ka treguar se cilin nen e ka shkelur AL me vendimin e saj dhe nuk ka ofruar asnjë argument ligjor. Ka kërkuar që në bazë të dispozitave ligjore, gjykata ta refuzoj ankesën e ankuesit.

Me dt.22 shkurt 2024, gjykata ka kërkuar nga ankuesi që të bëjë dorëzimin e provave shtesë dhe atë: kopjen e librezës së punës, kopjes e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe listën e pagave që pretendon se NSH i ka mbetur borxh si dhe prova tjera që dëshmojnë pretendime ankimore, si dhe të deklarohet lidhur me aktgjykimin C.nr.1074/05 nëse është atakuar nga pala e paditur si dhe të sjellë të njëjtin me vulën e plotëfuqishmërisë. E autorizuari e ankuesit e ka pranuar urdhrin me dt.28 shkurt 2024, dhe deri në kohën e përpilimit të këtij vendimi nuk i është përgjigjur të njëjtit.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086, të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2, e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësia apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa par.3, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse palët e tilla dështojnë që të paraqesin apo dorëzojnë provat e tilla, atëherë vlerësohet se palët nuk kanë përmbushur barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen

faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmojë se i takon kompensimi për paga të pa paguara për periudhën nga gushtit i vitit 2001 e deri në përmbushje të obligimeve. Ankuesi ka dorëzuar Kopjen e vendimit të kundërshtuar, Kopjen e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Kopjen e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Kopjen e aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Vushtri C.nr.1074/05 dt.19.12.2005, Kopjen e aktvendimit të Gjykatës Komunale në Vushtri E.nr.120/06 dt.27.03.2006, Kontrata e punës e lidhur në mes të NSH-së dhe ankuesit nr.8190 dt.01.03.2002. Ankuesi ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të ankesës së tij edhe pas parashtrimit të urdhrin të dt.22 shkurt 2024.

Nga kjo gjykata vjen në përfundim që parashtruesi i ankesës nuk i ka përmbushur kriteret themelore të ankesës. Ankuesi do të mund të dorëzonte prova relevante në mbështetje të pretendimeve të tij ankimore, siç janë dokumentet me anë të së cilave do të dëshmonte se sa ka ofruar shërbime pranë ndërmarrjes, cila ka qenë paga të cilën ankuesi e ka pranuar nga e njëjta, si dhe listën e pagave të cilat pretendon se ankuesit i kanë mbetur borxh. Gjykata gjen se, në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura në provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara. Provat të cilat i ka dorëzuar ankuesi nuk e dëshmojnë të drejtën e pretenduar, andaj dhe pretendimet e tij nuk janë të bazuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta procedurale. Ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore me dt.03.12.2021.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Dr.sc.Murat Hulaj, Gjyqtar

.